



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:091512

Datë: 26.02.2025

Numri i dokumentit: 06908499

**C.nr.1539/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, gjyqtari Baki Shigjeqi, me praktikanten D.O. duke vendosur në çështjen juridiko - kontestimore të paditësit G.F. me numër personal ..... me vendbanim në Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Prisig”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson juristja E.E. nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit njëmijë e pesëqind euro (1,500.00 €), jashtë seance me datë 26.02.2025, mori dhe përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia-**

- I. REFUZOHET E PABAZUAR** në tërësi kërkesëpadia e paditësit G.F. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të ***I. APROVOHET*** kërkesëpadia e paditësit G.F. nga Prizreni, në tërësi si e bazuar, ashtu që ***II. OBLIGOHET*** e paditura Kompania e Sigurimeve “Prisig”, me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit material për të gjitha kategoritë e dëmit, paditësit t’ia kompensoj shumën prej 1,500.00 euro, e gjithë këtë me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë (dt.29.04.2022), e deri në pagesën përfundimtare nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim. ***III. OBLIGOHET*** e paditura Kompania e Sigurimeve “Prisig”, me seli në Prishtinë që paditësit t’ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në afat prej 15 ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim”.

**A r s y e t i m**

Paditësi G.F. me vendbanim në Prizren, përmes të autorizuarit të tij, Av. D.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 10.05.2022, ka paraqitur padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Prisig”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 1,500 euro e deklaruar si në petitum të kërkesëpadisë.

I autorizuari i paditësit në padi ka theksuar se më datë 18.04.2022, ka ndodhur aksident i komunikacionit, ku deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të vozitësit të automjetit A, i cili duke mos i respektuar rregullat e komunikacionit shkakton aksiden me dëme materiale në automjetin “B”, të tipit “Mercedes Benz 245”, me targa të regjistrimit: ..... ngjyrë hiri, viti i prodhimit 2009. Automjeti “A”, si shkaktar i aksidentit në momentin e shkakimit të aksidentit ka pasur të kontraktuar policën e sigurimit, andaj përgjegjësia për kompensimin e dëmit bie mbi Kompaninë e Sigurimeve “Prisig”, andaj meqë baza juridike e aksidentit nuk është kontestuese i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të bie aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesëpadia e paditësit.

I autorizuari i paditësit, Av. D.M. me parashtrësën e datës 21.02.2025, e ka njoftuar gjykatën se me të paditurën, kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit të shkakuar në aksidentin e datës 18.04.2022, andaj edhe në mungesë të interesit juridik të procedimit të kësaj çështje, heqin dorë nga kërkesëpadia.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësit G.F. me vendbanim në Prizren, i cili në këtë çështje kontestimore përfaqësohet përmes avokatit D.M. nga Prizreni, konstatoi se kërkesa e kontestit është e disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 149, paragrafit 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) – me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”* – pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë, e bazuar në nenin 2 par.1, lidhur me nenin 3 par. 1 dhe 2, e lidhur me nenin 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
2022:091512, 26.02.2025

**G j y q t a r i,**

---

**Baki Shigjeqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën. Në kuptim të nenit 181, paragrafit 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.